

29 dhjetor 2015, Prizren

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Komunat e Kosovës nuk i kanë përmirësuar kushtet e jetesës për PNV-të

Katër komunat e mëdha të Kosovës, Prishtina, Prizreni, Peja dhe Gjlani, përfshirë këtu dhe nivelin qendror të qeverisjes sipas Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) me veprimet që kanë ndërmarrë nuk kanë qenë efikase dhe efektive për përmirësimin e kushteve të jetesës së Personave me Nevoja të Veçanta përkatësisht Personave me Aftësi të Kufizuara Fizike (PAFK).

Në raportin e performancës “Qasja për Personat me Aftësi të Kufizuara Fizike” të ZAP-it, ku auditimi mbulon periudhën 2013-2015, është konstatuar se përkundër përpjekjeve për përmirësimin e qasjes në infrastrukturë fizike dhe hapësira për PAFK, megjithatë rezultatet e deritanishme janë të kufizuara.

Auditori ka vlerësuar se masat e ndërmarra në mënyrë të rastësishme dhe në mungesë të priorizimit, nuk i kanë zgjidhur problemet, pastaj se objektivat e parapara në Strategjinë për PAK-të dhe Planin e Veprimit janë përmbushur në masë të ulët, dhe se indikatorët tregojnë se situata në këtë aspekt mund të jetë e ngjashme edhe në komunat tjera.

Ngecjet e hasura sipas ZAP-it, sa i përket nivelit lokal, kanë të bëjnë me faktin se shumica e komunave nuk kanë arritur që të themelojnë grupe punuese për identifikimin e nevojave dhe vlerësimin e situatës si bazë për priorizim; se komunat nuk kanë inkoorporuar qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuar në planifikimin strategjik; se ato nuk kanë siguruar mjaftueshëm forma të brendshme apo të jashtme të financimit, derisa gjatë licencimit të ndërtimeve të reja (lejet e ndërtimit dhe certifikatat e banimit), nuk janë marrë parasysh kërkesat që dalin nga kornizat ligjore. Gjithashtu Auditori ka gjetur se edhe organizatat në nivelin qendror nuk kanë funksionuar siç është synuar.

Qasshmëria sipas ZAP-it është një nga fushat më problematike që duhet të përmirësohen, në mënyrë që të krijohet qasje më e mirë për personat me aftësi të kufizuar në të gjitha aktivitetet e shoqërisë (arsim, shëndetësi, punë). Aktualisht këto janë pengesa të mëdha, që pengojnë PAK-ët që të gëzojnë mundësitë e barabarta, të cilat qytetarët tjerë i gëzojnë. Pengesat e tilla sipas Auditorit janë barrierat strukturore në ambientet e ndërtuara, mungesa e planifikimit urban, planifikimi joadekuat i ambienteve të brendshme, etj. Po ashtu Komunat kanë dështuar edhe në krijimin e sistemeve informative mbi lëvizshmërinë në qytet dhe mbi qasjen nëpër objekte, si element i rëndësishëm i cili kontribuon në përmirësimin e jetës së PAFK.

Në këtë raport, komuna e Gjilanit është veçuar në një pikë, për shkak se ka arritur të themelojë Grupin Punues për të identifikuar dhe për të bërë vlerësimin e nevojave për PAK, derisa për tri komunat tjera theksohet se kanë punuar pjesërisht drejt krijimit të një ambienti të qashtëm për PAFK, ku aktivitetet e tyre janë realizuar në baza *ad-hoc*, pa ndonjë vlerësim më afatgjatë strategjik dhe nuk është kryer vlerësimi i nevojave për PAK.

ZAP përmend se edhe Raporti i Progresit për Kosovën për vitin 2015, ka theksuar se PAK vazhdojnë të ballafaqohen me mbështetje joadekuade Institucionale dhe shëndetësore, dhe qasje të dobët.

EC Ma Ndryshe përkujton se qytetarët me aftësi të kufizuara ballafaqohen me lloje të ndryshme të barrierave, të cilat i pengojnë ata në pjesëmarrjen e plotë e efektive në shoqëri, në mënyrë të njëjtë me të tjerët, duke i penguar kështu për të bërë një jetë të pavarur, të dinjitetshme dhe të vetëkënaqshme.

Në Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, e drejta për arsim, shëndetësi e punësim, zënë vend të rëndësishëm, sikurse edhe në Deklaratën e Përgjithshme mbi të Drejtat e Njeriut, zbatimi i së cilës garantohet me Kushtetutën e Kosovës. Disa nga parimet e përgjithshme të Konventës së sipërpërmendur janë "respekti për dinjitetin, autonominë individuale, përfshirë lirinë për të bërë zgjedhjet personale, dhe pavarësinë e personit... pjesëmarrjen dhe përfshirjen e plotë dhe efektive në shoqëri".

Prandaj EC Ma Ndryshe rekomandon Komunitet që të ndërmarrin veprime për zbatimin dhe promovimin e këtyre vlerave, krahas mos diskriminimit, qasjes, mundësive të barabarta për të gjithë, etj.;

Komunitet sikurse edhe niveli qendror duhet të zbatojnë të gjitha rekomandimet e dhëna nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, në lidhje me masat dhe veprimet për përmirësimin efektiv të qasjes fizike për PAKF;

Gjithashtu Komunitet rekomandohen që në politikatat e tyre publike të përvetësojnë qasjen e bazuar mbi të drejtat e njeriut, atë të 'udhëve binjake', të përfshijnë PAK në vendimmarrje dhe të sigurojnë financim të duhur për shërbimet për PAK.

Projektin "Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale" EC Ma Ndryshe ka nisur që ta zbatoj nga maji i vitit 2015, falë përkrahjes së Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë, i cili ka shtrirje në komunitet e mëdha të Kosovës, Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Gjilan, Ferizaj dhe Gjakovë, sikurse edhe në Suharekë, Rahovec, Malishevë, Dragash, Mamushë dhe Shtërpçë. Projekti në fjalë ka për qëllim që ti asistoj komunitet në identifikimin e mangësive kryesore sa i përket transparencës sikurse edhe të ofroj udhëzime për adresimin dhe tejkalimin e tyre. Indeksi i Transparencës paraqet edhe një përpjekje të strukturuar për të mbështetur komunitet e Kosovës në përmbushjen e standardeve të qeverisjes së mirë, të përcaktuara me reformën e qeverisjes lokale dhe agjendën evropiane të Kosovës.

Me respekt,
Elmedina Baxhaku, Monitoruese
OJQ EC Ma Ndryshe
Rr. Saraçët, Nr. 5 - Prizren
Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr. 5, Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy
Pristina

Projekti "Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale" përkrahet financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.